

Z. Eduard Ypi është zgjedhur anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurences me Vendimin nr. 84, datë 30.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Ypi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, dega Financë - Kontabël (1975).

Në karrierën e tij profesionale të pasur dhe të gjatë në fushën e ekonomisë dhe financave, Z. Ypi ka ushtruar një sërë funksionesh drejtuese dhe menaxheriale në sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë.

Në periudhën 1992-1993 ka punuar Zv.Ministër i Punës, Përkrahjes Sociale dhe Emigracionit.

Në periudhën 1995 - 1997 ka punuar si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Bordit të Administrimit të Bankës Kombëtare Tregtare, dhe në vitin 1997 për një periudhë tremujore është emëruar Ministër i Privatizimeve.

Pas vitit 1997 ka punuar në detyrën e Administratorit të Përgjithshëm të Konfindustria Shqiptare, Drejtor i degës së Bankës Credins Vorë. Në periudhën 2007 - 2008 ka punuar si Administrator i Përgjithshëm i Birra Korça dhe gjatë periudhës 2009 - 2013, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit në Ministrinë e Financave.

Ai ka qenë pjesëmarrës në shumë seminare, konferenca dhe takime kombëtare e ndërkombëtare.